



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 30.05.2023

Nr: 166

Ora: 15:00

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 78, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA “PARTIA
DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 30.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”, përfaqësuar nga z. Shkëlqim Sulo dhe nga z. Klardi Xhemali.

OBJEKT: 1. Kundërshtim i tabelës së rezultateve për QV nr. 3239 të GNV nr. 1, datë 16.05.2023, të KZAZ nr. 62, Mallakastër.

2. Rinumërim dhe rivlerësim i votave të vlefshme dhe të pavlefshme në kutitë e votimit për këshill për QV 3239.

3. Ndryshimin e tabelës për rezultatin për këshillin bashkiak Mallakastër duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave.

BAZË LIGJORE:

Nenet 123/1 dhe pika 2 e nenit 124 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Në datën 14.05.2023, në 61 bashki në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse kanë plotësuar dhe miratuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për kryetarët e bashkive dhe për këshillat bashkiakë. KZAZ nr. 62, bashkia Mallakastër ka miratuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për këshillin e bashkisë me vendimin nr. 528, më datë 16.05.2023, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë, bashkia Mallakastër”.
2. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”, përfaqësuar nga z. Shkëlqim Sulo dhe z. Klardi Xhemali të cilët kanë kërkuar kundërshtimin e vendimit nr. 528, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 62, bashkia Mallakastër, si dhe ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të këshillit bashkiak Mallakastër sa i përket rezultatit për QV nr. 3239/00, sipas rezultatit të saktë të pretenduar nga ata sepse Grupi i Numërimit të Votave, pozicionuar në tavolinën nr. 1, për shkak të lodhjes, kanë përlllogaritur gabim votat për subjektin PDIU në tabelën e rezultateve për QV nr. 3239/00.
3. Për të provuar pretendimin e tyre, përfaqësuesit e subjektit ankues sollën si provë shkresën nr. 5229.1 prot., datë 18.05.2023, dërguar në KQZ nga KZAZ-ja nr. 62 Mallakastër, ku kërkohet *rishikimi i vlerësimit të numërimit të votave për QV nr. 3239/00, duke argumentuar gabimin*

njerëzor të kryer nga ana e GNV për shkak të lodhjes dhe ngarkesës së punës me orar të zgjatur.

4. Provë tjetër e sjellë nga ankuesit ishin fotografi të fletëve të votimit në favor të subjektit zgjedhor PDIU, që nuk ishin numëruar saktë në QV nr. 3239/00; të marra nga pamjet filmike që ankuesit iu vunë në dispozicion nga KQZ.
5. Kërkesa ankimore nr. 78, datë 22.05.2023 iu paraqit KAS-it, i cili në seancë paraprake vendosi pranimin e saj për shqyrtim me relator z. Elvis Çefa. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 30.05.2023, ora 15:00. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, si dhe përfaqësuesit e palës ankimuese z. Shkëlqim Sulo dhe z. Klardi Xhemali.
6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën ankimore nr. 78, datë 22.05.2023;
 - Vendimin nr. 528, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 62, bashkia Mallakastër “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Mallakastër”;
 - Shkresën nr. 5229/1 prot., datë 18.05.2023 dërguar nga KZAZ nr. 62 Mallakastër;
 - Pamjet filmike të tavolinave të numërimit për të gjitha GNV për këshill bashkiak në KZAZ nr. 62, Mallakastër (material hard-disk);
 - Kutinë e votimit të QV nr.3239/00, të KZAZ nr. 62, bashkia Mallakastër.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Provat e administruara nga pala ankimuese nëpërmjet pamjeve filmike përbëjnë indicie të mjaftueshme për KAS për të bërë kqyrjen e fletëve të votimit të ndodhura në kutinë e votimit

për këshillin e bashkisë Mallakastër, në kuptim të pikës 1 të nenit 138 të Kodit Zgjedhor, përkatësisht për qendrën e votimit nr. 3239/00, të KZAZ nr. 62, bashkia Mallakastër.

7. Për këtë arsye, me vendim të ndërmjetëm të KAS u vendos hapja e kutisë së votimit të sipërcituar dhe kqyrja e saj, e cila u zhvillua në seancë publike në sallën e seancave të KAS në prani të palës ankimuese, konform parashikimeve të pikës 2 të nenit 138 të Kodit Zgjedhor. Nga verifikimi i fletëve të votimit në kuti rezultoi se në favor të subjektit "PDIU" kishte në fakt 63 vota, nga 0 vota të pasqyruara nga grupi I numërimit. Ndërkohë, subjekti "PS" nga 161 vota të pasqyruara, rezultoi që në fakt kishte 98 vota. Numri i votave për subjektet e tjera nuk kishte ndryshime.
8. Parregullsitë e mësipërme konfirmojnë pretendimet e ankuesit "Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet" dhe si të tilla janë të mjaftueshme që KAS të pranojë ankimin e këtij subjekti, duke ndryshuar tabelën përmbledhëse të rezultatit të KZAZ nr. 62, bashkia Mallakastër dhe duke pasqyruar në të rezultatin e kutisë së votimit për QV nr. 3239/00.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja "c" dhe 143, pika 1, shkronja "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 78, datë 22.05.2023, të depozituara nga subjekti zgjedhor "Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet".
2. Korrigjimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për këshillin bashkiak, KZAZ nr. 62, bashkia Mallakastër, sipas gjetjeve të konstatuara nga KAS, sipas tabelës bashkëlidhur vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më 30.05.2023.

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

QARKU FIER
KZAZ NR. 62
GN NR. _____
QV NR. 3239/00

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

TABELA E REZULTATEVE PËR QENDRËN E VOTIMIT
Për këshillin e bashkisë Mallakastër

1	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej	246	DyqindDyzetëGjashtë
		gra	112	NjëqindDymbëdhjetë
2	Fletë votimi të papërdorura		488	KatërqindTetëdhjetëTetë
3	Fletë votimi të dëmtuara		0	Zero
4	Fletë votimi të gjetura në kuti		246	DyqindDyzetëGjashtë
5	Vota të pavlefshme		6	Gjashtë
6	Vota të vlefshme		240	DyqindDyzetë
7	Fletë votimi të hedhura gabim		0	Zero

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

Nr	Subjektet Zgjedhore	Numri Votave të Vlefshme	
		Me shifër	Me fjalë
1	Bashkë Fitojmë	23	NjëzetTre
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	98	NëntëdhjetëTetë
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	4	Katër
4	Partia Republikane Shqiptare	2	Dy
5	Partia Levizja e Legalitetit	0	Zero
6	Partia Demokracia Sociale	3	Tre
7	Aleanca Liberale e Djathtë	1	Një
8	Partia Socialdemokrate	7	Shtatë
9	Partia Demokratike	25	NjëzetPesë
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	2	Dy
11	Fryma e Re Demokratike	1	Një
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	63	GjashtëdhjetëTre
14	Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë	4	Katër
22	Partia Unitetit Kombëtar	6	Gjashtë
32	Partia Komuniste e Shqipërisë	1	Një
	Gjithsej vota të vlefshme	240	DyqindDyzetë